



Anita Pajaziti

*Njëra ndër krijueset e reja, e cila është etabluar në qarqet e krijueseve ne vendin tonë është Anita Pajaziti. Është nxënëse në vitin e tretë të SHMKM "Nikolla Shtejn" në Tetovë. Arsimin fillor e ka kryer në ShfK "Fan Noli" të f. Pallaticë. Krijime letrare poetike ka filluar të krijoj që si nxënëse në shkollën fillore. Poezitë e saja i ka të postuara të faja e shkollës ku dhe ka kryer arsimin fillor. Poezia e parë e postuar në në faqen e shkollës fillore është "A thua vallë" me të cilën nis dhe rrugëtimin në rajshin e krijimeve poetike. Me krijimet e saja poetike është shfaqur në shumë Manifestime shkollore*

*e Komunale të organizuara nga institucione të ndryshme. Po ashtu si poete e re është prezentuar në shumë emisione të televizioneve lokale e nacionale. Ka moderuar emisionin "Një bisedë me ne" në Tv Pollogu. Ka qenë e ftuar në emisionin "Radio Dritare Shqip" të moderatores Ema Bruci" si dhe bashkëmoderatore te një emision i Psikologes Ema Bruci. Është prezentuar edhe në Tv Klan Maqenoni në emisionin "Happy day".*

*Ka fituar çmimin "inkurajues" në konkursin poetik Gjergj Kastrioti Skënderbeu.*

*Ajo vazhdon të jetë e ftuar në emisione nëpër trojet Shqiptare për tua shpalosur lexuesve talentin, shkrimet, suksesin e madh që ka bërë për një kohë të shkurtër.*

*Ka marrë pjesë në konkurse letrare poetike të organizuara nga institucione komunale e regjionale. Është anëtare e Shoqatës së shkrimtarëve "Oeneum" të Tetovës. Ka të botuar veprën e parë me poezi "E pathëna", ka të shkruara shumë krijime letrare poetike të cilat do i përmbledh në veprën e dytë të sajë të cilën shpresojmë që ta botoj së shpejti. Bashkëjetoj me familjen në f. Pallaticë*

ANITA PAJAZITI - MUZA E PËRJETËSISË

# Muza e përjetësisë

Anita Pajaziti

Tetovë  
2024

Anita Pajaziti

Muza e përjetësisë

Maj  
2024

*Redaktor:*

Muaxher Haruni

*Lektor:*

Rami Kamberi

*Recenzent:*

Merita Isaki

*Korektor:*

Muaxher Haruni

*Realizimi kompjuterik dhe ballina:*

Emin Haruni

*Shtypi*

Tringa Design – Tetovë



Dua të jem me ty, edhe në përjetësi.

## **Muza e përjetësisë**

Më tha të krijoj vargje,  
Vargje të bukura të dashurisë,  
Vargje të jetës e lumturisë,  
Vargjet e mia të përjetësisë.

## **Akoma të kërkoj ty**

Të kërkoj,  
të ndjek ty gjatë gjithë jetës,  
ndjek hapat e tu siç më mësove,  
e kërkoj te çdo person,  
thjeshtësinë e shpirtit tënd.  
Të kërkoj edhe në varr,  
e di se tash je nën dhe,  
të kërkoj aty,  
dhe gjej qestinë që ma dhuron.  
Kërkoj në këtë botë qetësi,  
kërkoj, gjurmoj,  
të gjejë lumturinë te vetja,  
jo te dikush tjetër,  
pasi ashtu më the ti,  
prej ditës që ike nga kjo botë,  
kërkoj lumturinë,  
s'po e gjej qetësinë.

Ti nuk mund jesh artist edhe nëse luan rolin e artistit



## **Artist**

Dikush

luan rolin e artistit,  
dikush  
aktron me jetën e tij.

Dikush

aktrimin e ka profesion  
tallet me veten,  
tjerët i malltreton.

Kush e ka n'të drejtë  
e kush manipulon,  
këtë deri tash  
askush se ka thënë.

E në fund të ditës  
të gjithë një jetë jetojmë,  
si artist që aktron  
apo si të tjerët  
që mezi mbijetojnë.

## **Çka**

Çka ndodh  
nëse tretemi  
te sytë e njëri-tjetrit?

Çka do të ndodhte  
nëse do të kishim  
të njejtin shikim?

Çka do nodhte  
nëse do kishim  
të njejtin qëllim?!

Buzëqeshjen e mbulova me dhimbje

## **Dhembje**

Dhimbjen e kam në asht  
po munohem të humb dhe buzëqeshjen,  
a nuk është kjo marëzi  
për të shkretën dashuri.

Botë e stisur plot dhembje  
shumë fjalë e shumë iluzione,  
ditë të hidhura dhe dilemë  
dhembje plotë dhe monotone.

## **Dikush**

Ti deshe për mua  
të më bëhesh kthesë,  
e unë për ty në këtë botë  
t'u bëna shpresë në jetë.

Në fund të ditës  
shpresa përfunoi  
në rrugët tona  
gjithçka rifilloj.

E ardhmja të pret pa ne të dy.

## **E ardhmja**

E ardhmja  
ty të pret,  
kurse e kaluara  
për ty mbetet një kujtim,  
kurse për mua  
do ngelet  
një i hidhur mësim.

Atje ku për herë të parë  
u takuam rastësisht,  
aty të thash, ec tani ik,  
e ardhja ime  
diku larg më dërgon,  
në ëndrrat e mia  
jetën të jetoj.

## **Egoja**

Ndonjëherë egoja e tepërt  
për çdo ditë ty  
shumë të lëndon,  
por nuk të lë  
ta thyesh krenarinë  
që e ndërtove me vite,  
këtë në jetë a e kupton.

Egoja jonë nuk u ngop kurrë  
ajo kalon çdo cak e kufi,  
egoja jonë mbrpshtësi e betuar  
kush e kalon atë është njeri i edukuar.



## **Gota e dashurisë**

Në shpirtin e çdo njeriu  
ka një gotë emocioni,  
që mbushet me dashuri  
në shpirtë ju sjell lumturi.

E kërkonin dashurinë  
në vendet e gabuara,  
dashurinë nuk e gëzonin  
sa herë që në jetë atë takonin.

Edhe në kohën e gabuar  
gota mbushej me dashuri,  
lëndohej e thyhej  
sa herë kur stërmbushej.

Dashuria është e rëndësishme  
ndonjëherë e pakuptueshme ,  
dikur ndjehesha e afërt me ty  
por jo edhe tani....

Egoja jote bëri që të dashurohet me egon time

## **Haron**

Ndonjëherë  
prej egos së tepërt,  
haron personin  
që dashuron.

Ndonjëherë  
nuk të kujtohet  
kush je e ku shkon,  
e humb rrugën  
në oborin tënd.

Melodia e jetës në sfond  
e deh egon, e shkrumbon jetën,  
endesh lartë e poshtë  
kërkon atë person  
që dikur shumë e dashuroje,  
por tani për gjithçka është vonë.

## **I verbër**

Ti vjen vetëm kurr e ke të vështirë  
e di sekretin dhe trishtimin tim,  
të tjerët i gëzon mua më hidhëron  
prania e një të verbëri  
që dashurinë nuk e shijon.

Asgjë nuk është si më parë  
as buzëqeshja fallco,  
as dashuria juaj e verbër  
për një kohe të gjate.

Do më vidhje një lotë nga syri  
nuk kam forcë të them të shkosh,  
se ti nuk më do edhe i verbëri e sheh atë  
dhe thotë nuk më ke dashur kurrë.

Jeta është dhuratë e perendisë dhe sprovë e dashurisë

## **Jeta**

Është dhuratë prej Perendisë  
dhe bekim i dashurisë,  
nuk ndalon kur dëshiron  
deri sa shpirti se lëshon.

Sa e vështirë qenka jeta  
kur je edhe i vetmmuar,  
nuk ke kujt t'ia shprehish dhimbjet  
edhe kur ti je i gëzuar.

Shumë e rëndë është jeta  
flasin vitet mbi supe,  
shtohen hallet për çdo ditë  
në këtë botë që ska fytyrë.

## **Kohë e gabuar**

Person i duhur  
koha e gabuar,  
skenar i mirëshkruar  
skenë e gabuar,  
poemë e duhur  
rimë e gabuar,  
dhe një pjesë e ytja  
që nuk ishte kur e imja.

Idealist që nga hiçi  
gjithçka vetë krijuat,  
jetën flijuat  
dhe në kohë të gabuar,  
të vetëm jetuat.

Te letra u mësova ta urej emrin tënd



## Letra

Te letra gjej rehatinë  
te letra gjej qetësinë,  
në atë cope letre shpreh dashuri  
te letra vargjet krijoj,  
fshetësitë e jetës letra i posedon.

Duke kërkuar nga tjeret  
vetëm një copë dashuri,  
po ma dhuron këtë letër  
me shumë vargje mirësie.

S'po gjej dot fjalë për letrën  
plot fshetësi fjalët në vete ngërthen,  
sdo toleroj që letrën  
e fshetësitë e saja dikush ti asgjësoj.

## Më dëgjoni

Më dëgjoni çka po them  
mos anashkaloni fjalën time,  
lartë e poshtë po lakohet emri im  
për ç'gjë e ç'qëllim.

Do ju kundërshtoj deri në fund,  
për fjalët e pa kuptimta  
që fliten gjithkund,  
skam frigë edhe nëse ju humb  
sjam ajo që ju thoni  
ju them më mirë të më studioni.

Nuk dua të humb veten  
në terr dhe në errësi  
në fjalët e kota e plot marëzi,  
nuk ju ofenoj e as më ofendoni  
më thoni në fytyrë gjithçka që mendoni.

Me shkas ose pa shkas ne dy u takuam  
në kohën e gabuar

## **Me shkas**

Me shkas ose pa shkas,  
unë dua të flas,  
të them atë që mendoj,  
realitet të të tregoj.

Me shkas kërkojnë,  
që edhe unë të flas,  
të flas e fjalë të them,  
mbi historikun e vendit tim.

Me shkas do të flas,  
le të më dëgjojnë,  
ato që dëshirojnë,  
ato që nuk dëshirojnë,  
fjalët e mia t'i anashkalojnë.

Me shkas ose pa shkas,  
mos, mos më ndërprisni,  
se unë dua të flas,  
askë nuk lëndoj, askë nuk ofenfoj.

Me shkas ose pa shkas,  
askë mos ofendoni,  
askë mos bullëzoni,  
askush nuk iu lejon,  
të tjerët ti lëndoni.

## **Muza e dashurisë**

Dua përjestinë,  
dua dashurinë,  
dua dritën e mëngjesit  
që bie në sytë e mi,  
dua dashurinë e sinqertë  
të zhytyr në oqeanin e shpirtin tim.

Nuk dimë as të notojmë te ky oqan  
e as të largohemi,  
sa herë që themi ka marr fund  
ai oqan neve na mbyt përsëri,  
dëshira për të, ne rikthehemi te ai.

Eh...! tash u bë kohë  
plagët e vjetra, të thella spo mbyllen,  
them se dashuria jonë  
nuk përfundon deri në përjetësi

Gjuhët e ndryshme të kësaj bote janë  
gjuhët e dashurisë

## **Nuk i kuptojmë**

Njerëzit flasin  
në gjuhë të ndryshme,  
fjalët më të bukura  
dashurisë ia thonë,  
e bekojnë e mallkojnë  
eeee përsëri në të besojnë.

Nuk e kuptojnë  
gjuhën më të thjeshtë  
gjuhën e dashurisë,  
humbin pasurinë më të shenjtë  
lulen e rinisë.

Ata që s'kuptojnë  
gjuhën e dashurisë,  
ndjenjë rrugën e vetmisë  
ndjenjat e tradhëtisë.

## **Pas banakut**

Në banak e vetmuar jam ulur  
një pije për të shijuar,  
të dehem e të rikujtoj  
një kohë gati të shkuar.

Këtu sonte për ty  
ndjenjat më janë gërshetuar,  
me këtë koktel e me këtë melodi  
për ty dua të ngre një dolli.

Për ty jam zhdukur e jam humbur  
a të rikujtohem ndonjëherë,  
a të rikthehem në mendjen tende,  
apo ike, edhe ti më harove.

Pas banakut më le, u zhduke u humbe  
më lë vetëm të shkoj pasi ashtu ti këtë deshe,  
që të humbem e vetme nëpër rrugët e qytetit  
eh sikur një herë në jetë të më kishe thënë rri.



Ndoshta do kisha qëndruar  
ndoshta do kisha shkuar  
por të paktën nuk do isha e humbur,  
nëpër mendjen tënde siç u humba prej jetës sate.

Tani edhe Ti e di se më mungon,  
por unë nuk e pranoj,  
a e di sa herë kundërshtoja veten ,  
se të kam harruar por kur mundohesha t'iu harroj,  
atëherë më shumë dashurosha në ty.

Më mësove të dehem me dashuri

## **Për dashurinë**

Zemrat mund të thyhen  
por ti shpirt mos u dorëzo,  
dashuria kërkon kohë  
për të gjetur pasonin që do.

Njeriu dashurohet  
në mënyrën e tij siç është,  
e jo ti siç dëshiron  
në mënyrën tënde të dashurosh.

## **Për ty**

Të shkruaj për ty  
të ripërsërit të njejtat fjalë ,  
të të tregoj se të dua apo të urrej,  
të rikthehem te dashuria e vjetër,  
apo të të them shihemi në një botë tjetër.

Çdo varg që shkruaj  
në vete ngërthen zbraztirë,  
çdo medim për ty  
është kthyer në urejtje e mallkim.

E mallkoj kohën që të takova  
e mallkoj orën që u mashtrova,  
çdo fjalë që të them për ty  
është urejtje është trishtim.

## **Plagët**

Plagët plagosen,  
gjakosen, dhembin  
derisa ti shëroj ndokush,  
kurse kujtimet  
të vrasin përgjithmonë.

Plagët e trupit  
dhembin e përvlojnë,  
plagët e shpirtit  
kur nuk harojnë.

Plagët e zemër  
si fshehim dot,  
ngelin në mendje  
për jetë e mot.

## Unë jam ajo

Unë jam ajo  
Që në vend lotëve  
Buzqeshjen paravendos,  
Unë jam ajo  
Që përpiqem për tjerët  
E në fund e vetmuar mbetem,  
Unë jam ajo  
Që në vend të pikllimit  
Lumturia dhe gëzimi i të tjerëve  
Përparsi jete të kenë,  
Unë jam ajo  
Që mes dashurisë po zgjedh uretjen  
Pasi thonë se dashuria të lëndon,  
Jam ajo që në fund ditës  
E vetmuar ngelem  
E flas me hënën për time ardhmëri,  
Jam ajo cila jeton në një ralitet  
Të cilin nuk mund ta ndryshoj,  
Jam ajo e cila nuk mund të jem në sytë tuaj  
E në fund të ditës  
Jam vetëm me veten,  
E më pranoni ashtu siç jam  
Pasi unë e kam pranuar veten ashtu siç jam.

## Ty

Vetë më kërkove dashurinë  
lavdroheshe me dhuratën time,  
se ç'u bë me ty, nuk e di  
ike nga unë pa thënë lamtumirë.

Kur harove dashurinë  
pse s'kujton mirësinë,  
mos haro ditët e lumtura  
që së bashku përjetuam.

E di që do pendohesh  
e di që do rikërkosh dashurinë  
te unë nuk do e gjesh  
dashurinë e sinqertë.

## **E pa mundur**

Sado që u munduam  
të pamundurën të realizojmë,  
shumë pengesa patëm  
shumë nënkëmbëza na bënë.

Ti ike rrugës së pafund  
kokën se ktheve askund,  
edhe po të të shtronin  
tepikun e kuq,  
ti nuk u duke askund.

Sikur dallgët e detit të ndalonin  
edhe malet të rafshoheshin,  
të pamundurën nuk e bënim  
në jetë ëndrën të realizonim.



## Realitet

E djeshmja është histori,  
E sotmja realitet  
E hidhur apo e vërtetë,  
E nesermja ngelet një mister,  
Je i shqetësuar  
Me gjërat që ndodhin,  
Po ka një proverbë  
Që këtë vërteton  
*“Ti je mendimi i fundit  
në mendjen time  
para se të bie në gjumë  
dhe mendimi i parë  
kur zgjohem çdo mëngjes”.*

## Njeri

Sa njeri i ftohtë që je,  
Më i ftohtë se akulli,  
Edhe shpirtin e ke.

Sa e lënduar që jam  
Nga pa bestië që mi ke bë,  
Shpirtin ma ke lënduar  
Në buzë të varit më ke dërguar.

A e meritoja unë këtë  
Pyetje që përgjigje nuk gjeja,  
Sa hërë që mednoja  
Të ftohtë shpirtin tënd gjeja.

## **Tatu**

Plot tatu e kam jetën  
Edhe shpirtin me tatu e kam,  
Tatu nën lëkurë  
Dhe në trup më kanë ngelë.

Ike dhe nuk u ktheve  
Tatu në mua më le,  
Tatu jetën ma shëndrove  
Zbrastirë në jetë më shtove.

## **Në pritje**

As i sëmuri nuk pret mëngjesin,  
As i çmenduri nuk pret të kurohet,  
As dielli nuk pret perendimin,  
E as nga demoni nuk pritet mirësi,  
Unë të prita në pafundësi,  
Të prita se mos vallë do vish ti.

## **E vështirë**

E vështirë për t'u harruar,  
E vështirë për ta luajtur  
Rolin e të vështirës,  
E vështirë për ta pranuar  
Se mund të mbijetoj dhe pa ty,  
E vështirë të buzqesh pa arsye  
Mendova se ishte e vështirë të jem e fortë,  
E vështirë ishte deri sa pranova  
Se ne dy nuk mund të jemi një.

## Ne të dy

Ne të dy u përkasim  
copave të humbura,  
pasi copa të tilla i bëre ti.  
Të dy u humbëm  
në qytete të ndryshme  
nëjtë si valixhet në aeroport  
të paketuara rrugë marrë  
e gjetiu të ndara shkuan.  
Ne i paketuam zemra tona  
dhe në harëse i shpiejmë  
i ngulfatëm dhe i mbyllëm  
në kuti magjike të vetmuara.

## Sytë e tu

Sytë e tu më goditën si gëzhdoja,  
Trupi më shtanget me kujtimet tona,  
Sado që them nuk mbytem në dallget e detit,  
Njejtë si ti dhe perendimi diellit,  
Të mendova se ishe një rilindje për mua,  
Por u bëre thjesht kujtim i bukur i së kaluarës,  
Unë mora kahje tjetër të jetës,  
Po shkoj kah perendimi,  
Bashkë me veprimet e tua që më vranë si gëzhdoja.

## **Ajo ishte**

Ajo ishte e kërkuar,  
Ajo ishte e komplikuar,  
Ti e shihje dhe vëzhgoje nga afërt,  
Por ti kur nuk e afrove,  
Zemrën tënde me të sajën,  
Vetëm me thjeshtësi ajo të largoi,  
Kurse ti atë e largove nga vetja,  
Me egon tënde që e ushqeve me vite.



## **Jetë sikur në teatër**

Çdo hap që hodha  
Atë ditë në atë teatër,  
Më kujton jetën time  
Që është sikur një mini teatër,  
Në prova më kërkuan të aktroj  
Dhe mu duk si në jetën reale  
Se çdo ditë aktroj se jam e vërtetë,  
Mu kërkua të aktroj  
Sikurse ty të kam përballë  
Dhe të them të dua,  
Ishte e vëshirë atë fjalë ta them  
Më gozhduan ndjenjat që m'i kishe vvarë,  
Më thanë imangjino  
Sikurse është ulur aty, përballë teje  
Aktro me hijen e tij,  
Aktrova edhe me imagjinatën time  
Sikur t'ishe pranë meje  
Aktrova edhe me hijen tënde,  
Më thanë këtu je vetja  
Korekte me ndjenjat e tua,  
Ato nuk e dinin se nuk po aktroja  
Por ishte e vërteta që më mundonte prej vitesh  
E për një herë u shfaq edhe historia ime  
Edhe jeta ime, një jetë e plotë sikur në teatër.

## Muza e dashurisë

Dimensioni i saj është i pa kufizuar, vendi për ata që nuk mund të gjejnë një vend për veten e tyre, dhe që kërkojnë gjithmonë pas një krahu tjetër për t'u plotësuar. Gjithçka fillon me një lëmsh dhe trazirë që bën ndjenjat e një artisteje të trazoj dallgët e shpirtit dhe t'i përplas ato në reshta.

Emocioni i ngërthyer fortë në ndjenjën sublime që e bën atë specifike të dallueshme, tërheqëse, apasionante, intime të afron afër vetes në mënyrë brilante. Dallueshmëria dhe e veçanta e saj e bën të jetë Ajo. Ajo që trazon muzën e dashurisë, Ajo që thur vargje për të, Ajo që përjeton fortë emocionet e hatashme përtej edhe vetë asaj. E tillë është vepra që na prezantohet edhe vetë autorja me “Muza e përjetësisë” që vet emertimi krijues i autores Anita Pajaziti, fton lexuesit në botën e saj të çthurrur në tinguj të ëmbël e të trishta të asaj të quajtur dashuri. Ajo na referohet me vargje të ëmbla e të trishta që muzen e gjen brenda ndjenjës së thellë shpirtërore që buron si një reale dhe e humbur brenda saj. Ajo di se si të strehoi atë pa filozofuar sepse dashuria është e tillë shpesh herë nevojitet heshtje për ta kuptuar, e shpesheher, kuptohet edhe mes trazirës që shkakton.

Reflektimi në sytë e saj e bën atë ta pranoj ashtu siç është, qoftë në formë të çregullt. Sytë janë arma e fortë që godasin fjalët e pathëna, sytë janë ato që shkaktojnë miliona pyetje, e arsyesh, e nese nuk gjen dot asnjë arsye për ta kuptuar pse ke rënë në të, atëherë ja një arsye, kjo është dashuria.

*Çka ndodh  
Nëse tretemi  
Te sytë e njëri-tjetrit?*

*Çka do të ndodhte  
Nëse do të kishim  
Të njëjtin shikim?*

Poezia “Çka” i referohet asaj të lartpërmendur, dashurisë së një anshme, që kërkon të njejtën edhe nga ana tjetër, kërkon ngushllimin qoftë edhe mes syve, ata kanë forcë të përplasnin fortë ca grimëa për tu bashkuar, ashtu siç arinë të depërtoj edhe në botën krijuese të autorës, e cila gjenë muzën e saj për ta zbrazur në reshta. Një portret dashurie e heshtur apo e zhurmshme? Shpesh herë na fton në tabloun e saj duke luajtur me kartela hapur. Jeta nuk do ishte kuptim plote pa të. Njeriu gjithmonë është i zbrazët pa të, gjithmonë kërkon copzën tjetër për ta bashkuar, boshllëqet për të përmbushur, dhe një arsye më shumë për të jetuar. Ajo shfaqet si ëndrimtare e një shpirti të përhumbur në trazira emocionesh, duke u dhënë pas idealeve romantike dhe ndjenjës së pashmangshme.

Autorja nuk mohon të shfaqet si një e dashuruar e humbur, e zhytur thellë nën lekurën e botës intime, përtej asaj, përtej portës imagjinare, duke iu referuar asaj.

*Dua përjetime,  
Dua dashurinë,  
Dua dritën e mëngjesit*

*Që bie në sytë e mi,  
Dua dashurinë e singertë  
Të zhytur në oqeanin e shpirtin tim.*

Poezia “Muza e dashurisë” reflekton botën e dëshirave e cila shfaqet si një rrjet lidhse mes realitetit dhe ëndrrimtares, që kërkon thjeshtësinë dhe brishtësinë e asaj të qenurit e lumtur në oqeanin e krijimtarisë. Autorja shpesh di të na përplas mes idealeve dhe mes asaj të quajtur një dramë e trishtë e romantikës, mirëpo përsëri ngelet një art i bukur dhe pjesë e saj. Nëpërmjet vargjeve të saj, Ajo premton një krijimtari të mëtejshme, premton të shkruaj rreth asaj romantikës të përzier me emocione reale e sureale të paraqitura përballë lexuesve. Anita Pajaziti mbetet një krijuese e re që nëpërmjet veprave të saj jep mesazhe të forta tek lexuesit, qoftë rreth dashurisë e qoftë edhe përtej saj. Mbetet një krijuese e re që premton shumë rreth kësaj dege të krijimtarisë.

Nga Merita Isaki

## PËRMBAJTJA

Muza e përjetësisë.....	5
Akoma të kërkoj ty.....	6
Artist .....	8
Çka .....	9
Dhembje.....	11
Dikush .....	12
E ardhmja .....	14
Egoja .....	15
Gota e dashurisë.....	16
Haron .....	18
I verbër .....	19
Jeta .....	21
Kohë e gabuar .....	22
Letra .....	24
Më dëgjoni .....	25
Me shkas .....	27
Muza e dashurisë.....	28
Nuk i kuptojmë .....	30
Pas banakut .....	31
Për dashurinë.....	34

Për ty .....	35
Plagët .....	36
Unë jam ajo .....	37
Ty .....	38
E pa mundur .....	39
Realitet .....	40
Njeri .....	41
Tatu .....	42
Në pritje .....	43
E vëshitirë .....	44
Ne të dy .....	45
Sytë e tu .....	46
Ajo ishte .....	47
Jetë sikur n'teatër .....	48
Muza e dashurisë .....	49